

UDHËZIM
Nr. 12, datë 3.4.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 25, DATË 30.11.2007 “PËR
PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË VLERËS DOGANORE, BURIMET E
INFORMACIONIT DHE AFATET E PUBLIKIMIT TË DOSJES ME TË DHËNA TË
DISPONUESHME, SI DHE ZHDOGANIMIN E AUTOMJETEVE DHE PJESËVE TË
KËMBIMIT TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 36, të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 81.4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 2.11.2005, me propozimin e Komisionit *ad-hoc*, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007, në sesionin II: Burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, pika 10.1 zëvendësohet me fjalinë e mëposhtme:

“10.1. Çmimet e tregjeve ndërkombëtare, të marra nga Agjencia “Thompson Reuters” PLATTIS. Informimi për të dhënat e marra nga këto agjenci, të bëhet drejtpërsëdrejti nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.”

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani